



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivered	20-01-3	viti god	3
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org./Unit	Nr. Prot Bi Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSK	613/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1138/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës më numër A.nr.1138/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë bannimi Rr" "Mbreti Genc", Lagja MATI 1, Prishtinë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1138/2022 e datës 09.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër nr.174/2022 i datës 09.11.2022 i Zëvendësuesit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi , më datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7837/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 14.12.2022 përmes shkresës më numër protokolli 8033, kundër Vendimit Nr.174/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësuesit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankese të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 20.12.2022 ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7837/2022 të datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës më datë 14.12.2022; Vendimin me Nr.174/2022 të datës 09.11.2022 të Zëvendësuesit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Diplomën me Nr. 12 të lëshuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës; Vendimin Ref.Nr.6/1979 i datës 23.09.2015 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Diplomën universitare të datës 20.03.2009; Vendimin Ref.Nr.6/1963 i datës 23.09.2015 i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Diplomën universitare me Nr.140 të datës 08.06.2004; Kërkesën për përgjigje në ankese me numër protokoll 7985/2022 e datës 13.12.2022; Përgjigjen në ankese me numër protokoll 8224/2022 e datës 20.12.2022; E-mailin e datës 26.10.2022 nga [] për ankuesin; E-mailin e datës 05.10.2022 nga ankues për []; Vendimin me Nr.13/96 të datës 02.04.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 12.01.2023 nga A.B për Q.A dhe E-mailin e datës 12.01.2023 nga [] për []

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi bazuar në Vendimin Nr. 13/96 të datës 02.04.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës ishte emëruar Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, me mandat tre (3) vjeçar. Pas përfundimit të mandatit të parë me datë 01.04.2022, të njëjtit nuk i është vazhduar mandati, kështu që në kuadër të procedurës së sistemit pas përfundimit të mandatit, Njësia Përgjegjëse gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 13.09.2022 ka ftuar ankuesin në një takim informues duke vënë në dijeni të njëjtin së nuk ka pozita të kategorisë së mesme drejtuese të lira që i përshtaten përgatitjes profesionale të ankuesit, dhe njëkohësisht të njëjtit i ka propozuar listën e pozitave të kategorisë profesionale që sipas vlerësimit të DMZP-së i përshtaten kualifikimeve profesionale që posedon ankuesi.

Në përgjigje të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi përmes e-mailit të datë 05.10.2022 ka shprehur mendimin së për asnjë nga pozitat profesionale të ofruara nuk i përshtaten përgatitjes profesionale të tij, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes e-mailit të datës 26.10.2022 ka kërkuar nga ankuesi që të deklarohet për përzgjedhjen e njëjtes nga pozitat profesionale të ofruara brenda afatit prej pesë (5) ditëve, kurse në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi së ankuesi të jetë përgjigjur brenda afatit lidhur me kërkesën e DMZP-së të datës 26.10.2022.

Zëvendësuesi i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më Vendimin me Nr.174/2022 të datës 11.11.2022 ka liruar ankuesin nga shërbimi civil me arsyetimin së i njëjti ka refuzuar që të emërohet në pozitë të nivelit profesional.



Ankuesi kundër Vendimit me Nr.174/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësuesit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më pretendime ankimore së nga Njësia Përgjegjëse nuk i është ofruar asnjë pozitë e nivelit të mesëm drejtues, duke shtuar së nuk qëndron fakti së nuk ka pozita të lira të nivelit të mesëm drejtues për shkak së në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ka pozitë të Drejtorit të Departamentit që i përshtatet kualifikimit tim profesional, andaj, vendimi i kontestuar nuk përmban arsyetim të gjendjes faktike dhe nuk respekton parimet ligjore, duke kërkuar që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të detyrohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që të veproj në pajtim me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë duke emëruar ankuesin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese.

Në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua nenit 83 paragrafi 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"...6. Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës.8. Për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e tij/saj të parë, do të aplikohet neni 42, paragrafi 2 i këtij ligji".* Ndërlidhur me këtë neni 42 paragrafi 7 i këtij ligji ka përcaktuar se: *"...7.Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimat detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale".*, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se e drejta e sistemimit të zyrtarëve të kategorisë së lartë drejtuese pas përfundimit të mandatit (përfundimit të mandatit të parë apo mos vazhdim të mandatit) i njihet çdo nëpunësi civil të emëruar në pozitë të nivelit të lartë drejtues në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, si dhe çdo nëpunësi civil të emëruar në pozitë të nivelit të lartë drejtues sipas ligjit të shfuqizuar Nr.03/L-149/për Shërbimin Civil por që i njëjti ka qenë duke e ushtruar mandatin e tij me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj mbi këtë bazë ligjore rrjedhë së ankuesi ka gëzuar të drejtën e sistemimit-emërimit në pajtim me dispozitat ligjore si më lartë, pasi që i njëjti ka qenë i emëruar në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149/për Shërbimin Civil dhe së me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka qenë duke e ushtruar mandatin e tij të parë në këtë pozitë të nivelit të lartë drejtues.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit së nuk qëndron konstatimi i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë së nuk ka vende të lira të nivelit të mesëm drejtues pasi që në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ekziston një pozitë e lirë e drejtorit të departamentit që përkon me përgatitjet profesionale të ankuesit, Kolegji i Këshillit bazuar në përgjigjen në ankesë të datës 20.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka gjetur së në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë se pozita Drejtor i Drejtorisë së Administratës është e lirë dhe ushtohet nga zëvendësuesi dhe së për këtë pozitë kërkohet diplomë universitare drejtimi juridik, ekonomik ose drejttime që ndërlidhen me Administratën. Ndërlidhur me këtë Kolegji bazuar në shkresat e lendes ka gjetur së ankuesi posedon Diplomë universitare me numër 140 të datës 08.06.2004 përmes së cilës dëshmohet së ankuesi ka të përfunduar Fakultetin e Bujqësisë drejtimi i Fermës dhe Agrobiznesit, ndërsa posedon edhe Diplomën e datës 20.03.2009 për master në

Zhvillimin Lokal Krahasues si dhe Diplomën me numër 12 të datës 07.05.2015 për marrjen e gradës shkencore "Doktor" në fushën Ekonomi dhe Politikë Agrare, rrjedhimisht mbi bazën e këtyre dëshmime rezulton së ankuesi nuk posedon kualifikimin arsimor lidhur me pozitën Drejtor i Administratës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Për sa me sipër, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës konstaton së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, si organ përgjegjës për emërim të nëpunësve civil sipas procedurës së përcaktuar me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, sepse kjo njësi në mungesë të pozitive të lira të kategorisë së mesme drejtuese që janë të përshtatshme më përgatitjet profesionale të ankuesit, kishte propozuar për të njëjtin një listë të pozitive profesionale që i përgjigjen kualifikimeve të ankuesit, mirëpo ky i fundit në mënyrë të heshtur kishte lëshuar afatin për deklaram lidhur me përzgjedhje të një pozitë profesionale sipas listës së propozuar nga njësia gjegjëse, andaj duke u bazuar në nenin 42 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Theksuar si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1138/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit.
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.